



Shoqata Humanitare Bamirëse e Kosovës "Nëna Tereze"
The Kosova Humanitarian and Charitable Society "Mother Tereza"
Humanitarno Dobrotvorno Udruzenje Kosova "Majka Tereza"

38400 Prishtinë Rr. Agim Ramadani pn. Tel:00381 38 542 864, Fax: 542 869,
Web site: www.nenatereze.org e_mail: ntereze@yahoo.com

Raporti Vjetor

SHHBK NENA TEREZE

2023



RAPORTI I Punës 2023

Përmbajtja

1.Kosova gjatë vitit 2023.....	2
2.Organizata “Nëna Terezë” dhe sfidat e vitit 2023	2
3. Projektet e realizuar gjat vitit 2023 Piter Kovaq-Hoganos-Suedi	4
4.Adaptimi në Distancë	5
5. Rrjeti i Sigurisë - KK Fushë Kosovë.....	5
6. Projekti i Ndërtimit 2023.....	6
7. Kthimi Vullnetar dhe riintegrimi i qëndrueshëm.....	7
8. Të moshuarit.....	8
9 Dialogu Civil Kosovë-Sërbi.....	9
10.Sipas rajoneve u përkrahen kaç familje	10
11.Raporti financiar i vitit 2023.....	11
12. Buxheti v.2023.....	12

Për botuesin
SHHBK “NËNA TEREZE”
PRISHTINË
Mujë Krasniqi nn
ULPIANA U1/1 10 000
PRISHTINË

I.Kosova gjatë vitit 2023

Viti 2023 ka qenë vit sfidues në të gjithë botën. Brishtësitë politike lufta në Ukrainë, lufta në Gazë ndikuan që lëvizjet ekonomike të vështirësohen, kështu që edhe ekonomitë familjare dhe biznesin në Kosovë u prekën në mënyra të ndryshme.

Në Kosovë sipas Raportit të fundit të Komisionit Evropian për Kosovën, rreth 18 % e populates së Kosovës jeton në kufirin e varfërisë (45 Euro në muaj, ku 5.1 % e popullsisë jeton



nën kufirin e varfërisë ekstreme)

Sipas Statistikave në Kosovë **41.5 %** e punëkërkuasve të rexhistruar kanë qenë të **grup moshës 25-39 vjeq**, gjë që tregon se ende kemi fuqi punëtore të papunë relativisht të re.

Remitenat familjare nga Diaspora edhe matutje kanë qenë në ndihmë familjeve Kosovare, llogaritet se rreth 800 milion Euro kanë qenë dërgesa Cash përmes dërgesave të ndryshme familjare, si dhe rreth 1.5 miliard Euro kanë qenë Investimet kapitale familjare në forma të ndryshme (ndërtimtari, toka dhe hapje të bizneseve të vogla)

2.Organizata “Nëna Terezë” dhe sfidat e vitit 2023

Organizata Nëna Terezë gjatë këtij viti kalendarikë ka pranur shumë kërkesa për mbështetje. Kërkesat ishin të natyrës bazike, në ushqim, higjienë dhe veshëmbathje. Si organizatë e cila për mision ka përkrahjen e populates në perditëshmërinë e vet, ka mobilizuar


Ndonese Organizata “Nëna Tereze” angazhohet në uljen e varfërisë që nga rrënja e saj, synimi ynë mbetet të përkrah kategoritë më të prekura nga varfëria, si rastet sociale, të moshuarit, fëmijët, gratë mbajtëse të familjeve dhe komunitetet.

kapacitetet e veta për të i dalë në përkrahje popullatës së cenueshme. Organizata ka draftuar strategjinë dhe planin e veprimit në mënyrë që sa më shumë të maximizoj veprimet, kohën dhe koston për të ndihmuar familjet dhe individët në nevojë.

Projektet e organizates kryesisht janë të orientuara në ndërtimin e kohezionit social duke krijuar programe në përkrahje të kategorive të marginalizuara. Por jonetëm aq, organizata promovon edhe projekte të shoqërisë civile dhe të drejtat e njeriut.

3.Projektet e realizuara gjatë 2023

I.Organizata Loppan nga Hoganans, i qëndrojë besnik miqëve në Kosovë duke vazhduar realizimin e projektit të asistencës sociale në Regjionin e Mitrovicës. Projekti gjatë vitti 2023 ka përkrah mëse **480 familje me gjithësejt 2345 anëtarë**. Pakoja përkrahëse ishte në ushqim dhe higjenë, gjërat esenciale për familjet ne gjendje të rëndë sociale, familje me anëtarë Të hendikepuar,të moshuar apo nëna kryefamiljare.



“Let us stand in solidarity-not to specific country, race or religion, but rather to HUMANITY”-David Vox

2. Adaptimi në Distancë

Projekti

Adaptimi në distancë vazhdoj edhe në vitin 2023, duke përkrahur familje në nevojë. Projekti në vetvete përmban një seri mundësish për të adaptuar/përkrahur familje, individ apo fëmijë. Donacionet menaxhohen nga organizata dhe në baza mujore përkrahen me higjienë veshmbathje dhe pako ushqimore. Nga ky projekt janë mbështetur **217 familje me 980 anëtar, me pako ushqimore, ndersa me veshmjathje u përkrahen 601 familje** Pakot ushqimore dhe higjienike ishin në madhësi të ndryshme varesisht nga numri i familjeve por në përgjithësi, një pakë ushqimore kishte vlerën 35 euro. Njëzë vullnetimire që synojnë të kontribuojnë në zvogëlim të varfërisë në baza mujore dhurojnë të holla, veshmbathje dhe gjësende të ndryshme. Shpirti i solidaritetit ende vazhdon të jetë karakteristike e popullit tonë.

Jemi tejet mirënjohës për mundësinë të përkrahim kategori të ndryshme pa dallim feje, race, etnie apo gjinie.



3.. Rrjeti i Sigurisë - KK Fushë Kosovë



KK Fushë Kosovë përmes zyres së organizates sonë në Fushë Kosovë ka implementuar projektin Rrjeti i Sigurisë në kohë të pandemisë në Komunën e Prishtinës. Qëllimi i projektit është të zvogëloj numrin e familjeve skamnore në Fushë Kosovë dhe të permirësoj nivelin e ushqyeshmërisë dhe higjienës në qytetin e Fushë Kosovës. Gjithësejt u përkrahen **60 familje me më shumë se 303 anëtarë**, të etnive të ndryshme.

4. Projekti i Ndërtimit 2023

Në bashkpunim me Organizatën “Doors of life” Shqipëri bazuar ne mjetet e mbetura dhe te pashfrytzuara nga aksioni humanitar për mbledhjen e fondeve me rastin e termetit qe ndodhi ne Shqipëri perms aksionit medial në bashkpunim me Shoqaten Nëna Tereze Zvicerr u realizuan dy projekte. Këto mjete kan qene te destinuara për adaptim-meremetim të familjeve qe pesuan nga termeti. Organizata Dors of life Tiranë ka bërë përzgjedhjen e ketyre dy familjeve te prekura nga termeti ne Qytetin e Prrenjasit



Shtëpia familjes **Bedri Belba**



Shtëpia e familjes **Valentina Radici**

“A house is a home when it shelters the body and comforts the soul”-Philip Moffat

5. Kthimi Vullnetar dhe riintegrimi i qëndrueshëm

Kthimi i qëndrueshëm mbetet sfidë e vazhdueshme si për organizata qeveritare ashtu edhe ato jo qeveritare. Organizata “Nëna Tereze” tash e sa vite angazhohet në problematiken e tillëdhe ka qenë pikë fokusi për shumë rrjete dhe organizata në nivel European, siq është rrjeti European ERSO, si dhe anëtarët e saj individual. Gjatë vitit 2023 , Organizata ka vazhduar bashkëpunimin me **Caritasin e Belgjikës** me Danish Refugee Council (**DRC**) me seli në Danimarkë, **FRONTEX** etj. Poashtu në muajin Nëntor 2022 është nënshkruar Anex kontrata nr. 2 si dhe në muajin Prillë 2023 Anex 3 i kontratës bazë (8 mujore me **GIZ/DIMAK**, I cili ka për qëllim përmirësimin e jetës në aspektin ekonomik të personave të cenuar, të riatdhesuar, dhe potencial për megrim (**350 gra të viseve Rurale**) poashtu janë mbështetur edhe **11 OJQ**-poashtu të grave duke ua mundësua ngritjen e kapaciteteve të tyre për punë me të suksesshme në të ardhmen.



Gjithesëjt u perkraken: 11 organizata me 350 gra rurale 350 dhe 10 të kthyer vullnetarë përmes organizatave partnere. Programi në vetevetë ngrerthet përkrhaje multidiciplinate, duke filluar nga vlerësimi i kompetencave, keshillimi, trajnimi, përgaditja për treg të punës si dhe përkrhaje start up- grante.

6. Programi I të Moshuarve te vetmuar



Ky project është mbështetur nga disa donator Ministria e Drejtësisë ku janë mbështetur 30 të moshuar në regjionin e Prizrenit , pastaj nga Donatorët Caritas Austri dhe Komuna e Prishtinës janë mbështetur 35 të moshuar, po ashtu është përmblytur edhe projekti Live and Age with Dignity donacion I Save the Children ku janë mbështetur 30 të moshuar nga reghioni I Mitrovicës. Përveq përkujdesjes nga ekipi professional (Mjeku I pergjithshem, tekniku medicinal, punëtori Social) component ne vete ka qenë edhe mbështetja e rregulltë në baza mujore me artikuj të ndryshëm Ushqimor, Joushqimor dhe Higjenik. Rreziku i varfërisë, diskriminimi dhe izolimi është rritur ndjeshëm për shkak të krizës së COVID 19. Izolimi dhe ndarja nga miqtë, familjet dhe fqinjët, së bashku me frikën nga sëmundjet dhe pasiguritë në lidhje me aftësinë për të përmbushur nevojat e tyre në lidhje me ushqimin, medikamentet dhe furnizimet e tjera thelbësore vendosin një pjesë të madhe të popullsisë së moshuar nën stres psikologjik. Kesaj iu bashkua edhe ceshtjet e inflacionit te cmimeve te cilat preken gjithë boten Ky është veçanërisht rasti për ata të moshuar që jetojnë vetëm ose në familje me të moshuar të tjerë në kushte të privuara sociale. Ngritja e nivelit të social për një jetë më të dinjitetshme të këtij grupi personash Sigurimi I mbështetjes shëndetësore duke siguruar jetë të shëndetëshme Rritja e nivelit të ushqyeshmërisë së ketyre personave janë tre shtylla të projektit.

Ky project është mbështetur nga disa donator Ministria e Drejtësisë ku janë mbështetur 30 të moshuar në regjionin e Prizrenit , pastaj nga Donatorët Caritas Austri dhe Komuna e Prishtinës janë mbështetur 35 të moshuar, po ashtu është përmblytur edhe projekti Live and Age with Dignity donacion I Save the Children ku janë mbështetur 30 të moshuar nga reghioni I Mitrovicës. Përveq përkujdesjes nga ekipi professional (Mjeku I pergjithshem, tekniku medicinal, punëtori Social) component ne vete ka qenë edhe mbështetja e rregulltë në baza mujore me artikuj të ndryshëm Ushqimor, Joushqimor dhe Higjenik.

Rreziku i varfërisë, diskriminimi dhe izolimi është rritur ndjeshëm për shkak të krizës së COVID 19. Izolimi dhe ndarja

nga

"Pleqëri me Dinjitet"		
PERSHKRIMI I PROJEKTI		
Emri i Projektit	"Pleqeri me dinjitet"	Vendi i realizimit Regjioni i Prizrenit
Implementuar nga:	SHHBK Nena Tereze	Periudha implementuese 01/05/2023 - 28/02/2024
Mbështetur nga:	Ministria e Drejtësisë, Republika e Kosovës	

Qellimi dhe objektivat

- Qëllimi I këtij projekti është që të mbështeten 30 personat e moshuar ,të vetmuar dhe pa përkujdesje të mjaftueshme,duke e ngritur nivelin përkujdesjes shëndetsore ushqyeshmërisë dhe sociale në përaillthësi në Rajonin e Prizrenit

Ndersa objektivat e projektit Jane:

- Shërbime cilësore ditore për personat e moshuar dhe të vetmuar pa përkujdesje familjare-
- Ngritja e nivelit të social për një jetë më të dinjitetshme të këtij grupi personash-
- Sigurimi I mbështetjes shëndetsore duke siguruar mbështetje shëndetshme,referime ,keshillime
- Rritja e nivelit të ushqyeshmërisë së këtyre personave

Pershkrim i projektit

Në Kosovë, evidencat që tregojnë gjëndjen socio ekonomike dhe kualitetin i jetës të moshuarve është e mangët, gjëndjen e veshitreson edhe me shumë inflacioni i cili përfshiu tere boten, përfshire ketu edhe Kosoven me 11.2% inflacion ne shkalle te vendit.. Moshë e trete është kategori që kërkon vemendje te vecant, e para per shkak te mundesive te kufizuara



Perse nevojiten sherbimet në shtëpi?

Nevoja e një kujdesi afatgjatë po shtohet. Në vitin 2050 numri I të moshuarve të cilët nuk janë në gjendje të kujdesen për veten pritet të katërfishohet, një numër I madhë I tyre humbasin aftësinë për të jetuar të pavarur për shkak të paaftësisë për të lëvizur, dobësit tjera fizike apo mendore.

Nr	Emri I projektit	Nr I te perkrahurve	Donatori
1	Jeto dhe Plaku me Dinjitet	30	Save the Children
2	Pleqeri te dinjitetshme	30	Ministria e Drejtesise
3	Jeto dhe Plaku me dinjitet 2	35	KK Prishtine, Caritas Austria
	Gjithsejt	95 te moshuar perfitues direkt te projektit	

7. Dialogu Civil Kosovë Serbi

Ky projekt "Zhvillimi i mëtutjeshëm i dialogut civil në mes të Serbisë dhe Kosovës" është vazhdimësi e bashkpunimit në mes të OJQ-së Nëna Tereze dhe OJQ-se Qendra për Regjionalizem Novi Sad. Ky projekt mbështetet ng Zyra e Bashkimit Evropian me seli në Prishtinë.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit të financuar nga Bashkimi Evropian: "Zhvillimi i mëtutjeshëm i dialogut civil midis Kosovës dhe Serbisë "është të kontribuojë në ndërtimin e një lidhje dhe raporti të mirë fqinjësor midis Kosovës dhe Serbisë përmes dialogut civil përkatësisht avancimit të mëtutjeshëm të dialogut civil.

Objektiva Specifike 1: Sigurimi i mbështetjes së bashkëpunimit të të rinjve nga Kosova dhe Serbia në fushën e punësimit, arsimit, mjedisit dhe kulturës

Objektiva Specifike 2: Sigurimi i mbështetjes për angazhim aktiv në Dialogun Civil të të rinjve, grave dhe minoriteteve etnikë në Serbi edhe në Kosovë.


Ky projekt ka filluar së implementuari nga muaji Shkurt 2023 dhe do të përfundojë me 31.07.2026



Më poshtë do të listojmë donatorët nga muaji Janar- Qershor –Dhjetor 2023, si dhe numrin e familjeve sipas rajoneve Sipas Rajoneve u përkrahen kaq familje:

Nr.	Vendi	Nr. i Familjeve	Nr. I Anëtarëve	Donatori	Përkrahur me
1	Prishtinë	82	425	Bujari nensi, Bekim Gashi	Pako ushqimore higjenike
	Prishtinë	480	2640	Donator të ndryshëm	Pako higjenike dhe veshmbathje
	Fushë Kosovë	30	144	KK Fushë Kosovë	Pako ushqimore higjenike
	Prishtinë	8	36	Bujari/Nensi	Pako ushqimore higjenike
2	Pejë	100	545	Donator të ndryshëm	Pako ushqimore, higjenike, veshmbathje, pemë
3	Prizren	20	85	Donator te ndryshem	Pako ushqimore, Rroba te ndryshme, material ndertimor, karroca per te hendikepuar, vunica per pune dore
4	Mitrovicë	498	2010	Loppan	Pako ushqimore higjenike
	Gjilan	52	52	KFOR-i Amerikan	Pako/racione ushqimore dhe higjenike
Gjithesejt		1506	7357		

7357 anetare te perkrahur gjate 2023



4. Vlera e donacioneve dhe shpenzimet e tyre

Pershkrimi I projektit dhe Donatori	Saldo filles. 1/1/2023 €	Shtesat gjatë vitit 2023 €	Shpenzimi I-XII 2023 €	Saldo perfundimtar e 31/12/23 €
1. Caritas-Austria “ Live and age with dignity”	2,490.37	40,382.37	23,801.82	16,580.55
2. Projekti I Ndertimit te Shtepive SHHB Nëna Tereze Zvicërr	0.00	15,314.79	15,314.79	0.00
3. Projektet ditore Donatoret tjere	4,018.99	12,808.79	9,747.07	3,061.72
4 Projekt – ushqimit- Merita Mitrovicë- Piter Kovac Hoganos Suedi	9,450.76	25,338.76	23,041.60	2,297.16
5. Rrjeti I Sigurisë KK Fushe Kosovë	0.00	3,000.00	3,000.00	0.00
6. Projekti I te moshuarve MPMS-le	11,000.00	41,000.00	32,835.91	8,164.09
7. Projekti I Riatdhesimit- Kthimit GIZ-DIMAK	70,295.46	671,670.35	671,670.35	0.00
8. Voluntery return and Reintegration Caritas Belgium	4,404.58	4,404.58	4,404.58	0.00
9. Development Civic Dialogue between Serbia and Kosovo European Union Office in Prishtina	195,672.10	195,672.10	142,350.13	53,321.97


10. Project “ LIVE AND AGE WITH DIGNITY”				
Donator Save the Children International -Kosovë „SCI“	7,227.93	7,227.93	7,227.93	0.00
11. . Return and reintegration counseling project Denish Return Agency DRC	2,651.05	12,199.05	6,042.75	6,156.30
12.Research Podujev D4D	0.00	900.00	111.00	789.00
13 Jim Xhema Donacion SHBA	0.00	18,201.18	3,029.30	15,171.88
14 Return & Reintegration FRONTEx	0.00	68,650.00	21,716.95	46,933.05
15 Rrjeti I Sigurisë KK Prishtinë	0.00	7,000.00	4,316.56	2,683.44
Total	307,211.24	1,123,769.90	968,610.74	155,159.16

Buxheti SHHBK“NËNA TEREZE” 2023

Nr.	Përshkrimi	Shuma/EUR
I	Të hyrat e përgjithshme	1,123,769.90
II	Shpenzimet	28,368.3
	Amortizimi i mjeteve themelore	523.00
	Harxhimet e komunikimit PTT DHL	2,463.15
	Harxhimet e energjisë elektrike, ujit,ngrohjes	1,006.96
	Reprezentacioni, udhimet zyrtare	1,069.00
	Harxhimet e derivateve	10,072.03
	Materiali harxhues kancelarik	1,808.86
	Mirëmbajtja e zyreve, Sigurimi zyreve, higjena	699.61
	Mirëmbajtja e makinave	5,232.47
	Rexhistrimi i makinave	2,262.22
	Auditimi pasqyrave financiare, shpalljet prokurim	3,750.00
III	Bruto të ardhurat personale	137,296.00
IV	Realizimi direkt i projekteve	958,105.60

Ndarja e buxhetit 2023

■ Shpenzimet e implementimit ■ Shpenzimet direkte programore



MISIONI I ORGANIZATES

SHHBK Nëna Tereza është e përkushtuar të mbështesë dimensionet e kohezionit social duke ofruar perkrashje për grupet vulnerabel, dhe ndihmuar njerëzit të ndërtojnë komunitete të sigurta, produktive dhe të drejta.

Vizioni i Organizatës është të jetë një faktor ndihmës në ndërtimin e një shoqërie civile demokratike dhe të hapur ku të drejtat dhe vlerat e njeriut kultivohen dhe respektohen.

Thelbi I punes sonë

Familjet në nevojë - burra, gra, fëmijë, të moshuar - janë një pjesë jetike e përpjekjeve të bazuara në komunitet të organizates Nëna Terezë për të përmirësuar kushtet e tyre themelore të jetesës, për të rritur aksesin në kujdes shëndetësor cilësor dhe për të zgjeruar mundësitë ekonomike për të gjithë. SHHBK Nëna Terezë synon të ndihmojë duke ndërtuar një shoqëri të hapur civile, ku vlerat e të gjithë njerëzve do të respektohen dhe kultivohen pa dallim kombësie, feje apo race ku njerëzit do të jetojnë krah për krah me respekt dhe tolerancë reciproke.

Ne synojmë të perkrashim ndërtimin e një shoqërie demokratike multietnike duke perkrashur pajtimin dhe ndërtimin e paqes midis të gjitha etnive, si dhe t'u japim zë familjeve më të cenueshme të shoqërisë.

Organizata Nëna Terezë ofron programe që kontribuojnë në uljen e varfërisë. Ne ofrojmë mjete për ndryshim të qëndrueshëm për njerëzit më të cenueshëm ndaj urisë, diskriminimit dhe sëmundjeve. Shtrirja e punës sonë ka dimensione të shumëfishta duke përfshirë :

- Edukim, shërbime sociale dhe ndihma socio-ekonomike për komunitetet e cenueshme
 - Mbështetje për strehimin e komuniteteve në nevojë
 - Projektet të Shoqërisë Civile
 - Lehtësimi i procesit të kthimit dhe riintegritit dhe
 - Projektet e rrjetit të sigurisë.

Address: Muje Krasniqi nn Ulpiana UI/I 10 000 Prishtine Tel: +383 38 542 864/5

“Mother Theresa Society “-committed to shape social justice and better citizens’ welfare
Organizata Nënë Terezë” – e perkushtuar për të kontribuar në drejtësinë sociale dhe
mirëqenien më të mirë të qytetarëve



Health and social care integration